



Pranuar / Dorezuar Punëhënë/Pradato Received/Delivered	31.07.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBJK	5456/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.854/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga:Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, dhe Vjollca Sinani-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.854/2023 të datës 16.06.2023, të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë banimi në Rr." _____ Fushë Kosovë, kundër organit të punësimit, Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 31.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Përfundon Procedimi Administrativ** i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.854/2023 të datës 16.06.2023 të parashtruar nga ankuesi _____.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi** me Nr. 14-111/01-101298/23 i datës 19.05.2023 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës.

A r s y e t i m

Komuna e Prishtinës me datë 26.01.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me numër të referencës RN00010814 për "Specialist të shëndetit dhe higjienës mjedisore dhe profesionale", në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim, në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili i është nënshtruar fazave të procedurës dhe i njëjti është shpallur fitues në këtë konkurs, ndërsa ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4792/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër Vendimit me Nr. 14-111/01-101298/23 të datës 19.05.2023 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokolli 4792/2023 të datës 16.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me Nr. 14-111/01-101298/23 i datës 19.05.2023 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Njoftim nga Sektori i Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës i datës 16.03.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesi në procedurë, me qenë se si organ kemi anuluar këtë konkurs që është objekt që ndërlidhet me këtë ankesë nuk ka dërgue kërkesë për përgjigje në ankesë te organi i punësimit dhe duke shikue edhe dokumentacionin që ndërlidhet me lëndën A.nr.558/2023 konstatoi se **Përfundon Procedimi Administrativ** i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.854/2023 i datës 16.06.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, *sepse:*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 16.06.2023 ka pranuar ankesën e ankuesit _____ me numër protokoli 4792/2023 të regjistruar në shenjë A.nr.854/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr. 14-111/01-101298/23 të datës 19.05.2023 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës me arsyetimin se duhet të hetohet për ecurinë e mbarëvajtjes, anulimit të konkursit si dhe për përzgjedhjen-vlerësimin e kandidatëve.

Ndërsa ndërlidhur me këtë konkurs dhe objektin e kësaj ankese Këshilli me Vendimin me numër A.nr.558/2023 të datës 10.05.2023 me numër protokoli 4147/2023 ka shqyrtuar ankesën e ankueses R.M dhe të njëjtën e ka aprovuar si të bazuar ndërsa në pikën II të vendimit specifikohet: *“Anulohet konkursi me nr. referencës RN00010814 për pozitën “Specialist të shëndetit dhe higjienës mjedisore dhe profesionale”, në Drejtorin e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Prishtinës si dhe çdo akt tjetër që rrjedh nga kjo procedurë”*.

Bazuar në këtë Kolegji konstaton se meqenëse Këshilli brenda periudhës dy vjeçare ka vendosur meritorishtë në lidhje me këtë konkurs përmes vendimit A.nr.558/2023 të datës 10.05.2023 sipas të cilit konkurs ishte shpallur kandidatë fitues ankuesi mirëpo për shkak të shkeljeve ligjore i njëjti konkurs ishte anuluar nga këshilli sa i përket pozitës së rekrutimit *“Specialist të shëndetit dhe higjienës mjedisore dhe profesionale”* i shpallur përmes konkursit të datës 26.01.2023 nga Komuna e Prishtinës, dhe mbi bazë të këtij vendimi edhe ishte zbatuar i njëjti nga komuna e Prishtinës përmes vendimit me Nr. 14-111/01-101298/23 të datës 19.05.2023, që është objekt i kësaj ankese atëherë mbi këtë bazë ligjore ankesa e ankuesit sa i përket objektit është e konsumuar pasi që Këshilli ka vendosur meritorishtë sipas Vendimit me numër A.nr.558/2023 të datës 10.05.2023 me numër protokoli 4147/2023, atëherë Kolegji konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore në zbatim dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nen paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1. Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike”*, andaj kolegji mbi bazë të asaj që u tha si më lartë vendosi që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.854/2023 të datës 16.06.2023 të parashtruar nga ankuesi



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe bazuar në nenin 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.854/2023, datë 31/07/2023

Vjollca SINANI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.